

2000

DY MIJË LEKË



KARTËMONEDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE KARTËMONEDHA 2000 LEKË

PSE NJË SERI E RE?

Një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është të garantojë besimin e publikut në paranë tonë kombëtare. Ajo e bën këtë duke emetuar një kartëmonedhë që i komunikon publikut shqiptar siguri dhe qëndrueshmëri. Mbi 20 vjet pas hedhjes në qarkullim të serisë së vjetër të kartëmonedhave Lek, natyrshëm kishte lindur nevoja e përmirësimit me elemente të reja sigurie, për t'i bërë ato më të sigurt ndaj falsifikimit. Kartëmonedhat tona shërbejnë edhe si mbartëse të identitetit kombëtar. Përmes mjeshtrisë artistike, ato promovojnë historinë e Shqipërisë dhe theksojnë kontributet e personaliteteve të saj.

Për këto arsye, nga viti 2019, Banka e Shqipërisë filloi emetimin e një serie të re të kartëmonedhave Lek, me pamje të rifreskuar dhe elemente sigurie të përmirësuar. Kjo seri është prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës, duke u kujdesur njëkohësisht që edhe pamja e kartëmonedhave të jetë më moderne.

PREZANTIMI GRADUAL I SERISË VAZHDON

Pas hedhjes në qarkullim të kartëmonedhave 200 dhe 5000 Lekë të serisë së re në vitin 2019, dhe më pas të kartëmonedhave 1000 dhe 1000 Lekë në vitin 2021, vijon plotësimi i serisë me prezantimin dhe më pas hedhjen në qarkullim të prerjes 2000 Lekë.

Kartëmonedhat ekzistuese të kësaj prerjeje, do të vazhdojnë të qarkullojnë dhe të kenë kurs ligjor si mjet pagese, së bashku me kartëmonedhat e reja.

KËSHILLA PËR PËRDORIMIN E KARTËMONEDHAVE

Kartëmonedha përbën një vlerë kombëtare.

Trajtoje kartëmonedhën ashtu siç është: më shumë se një letër me vlerë. Përveçse mbart vlerën nominale, ajo paraqet një ndërthurje të vlerave artistike me elemente të identitetit kombëtar.

Ruaje kartëmonedhën në portofol.

Mos e dëmto duke e rrudhosur, përthyer, shkruar, ngjyrosur, prerë, ngjitur ose lagur atë. Kështu, ti ndihmon që ajo të qëndrojë në qarkullim sa më gjatë.

DHE MOS HARRO!!!

Lexo dhe përdor shifrën që shkruhet mbi kartëmonedhë! Mos i shto një 0! Mos e quaj as lek i vjetër, as lek i ri! Ai është thjesht LEK. Kërkoju edhe të tjerëve ta respektojnë atë, njësoj si ti.

Për më shumë informacion, vizito www.bankofalbania.org



DY MIJË LEKË

KA0000000

GUVERNATORI DREJTORI

ELEMENTET E SIGURISË

Kontrollo nëse kartëmonedha është e vërtetë, përmes verifikimit të elementeve të sigurisë me metodën “PREK, SHIKO, LËVIZ”.

PREK

Preke dhe ndieje kartëmonedhën me gishta.

Letra e kartëmonedhës është prodhuar nga pambuku dhe karakterizohet nga një tingëllim dhe konsistencë e veçantë.

- 1 **Shtypi i ngritur.** Ndieje shtypin e ngritur të vlera nominale, tekstet dhe portreti. Ndiej vijat e shkurtra përgjatë anës së majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë elementin e njohjes nga personat me aftësi të kufizuara shikimi.

SHIKO

Mbaje kartëmonedhën kundrejt dritës dhe shikoje me kujdes.

- 2 **Figurat ujore.** Portreti i kartëmonedhës, vlera nominale e saj dhe simboli i stilizuar i shqiponjës bëhen të dukshme.
- 3 **Filli i sigurisë.** Nga një shirit i ndërprerë, filli i sigurisë duket një vijë e errët e pandërprerë. Në të dallohen vlera 2000 Lekë dhe një stilizim i lules Gentiana.

LËVIZ

Lëvize kartëmonedhën në kënde të ndryshme shikimi, për të parë si ndryshon.

- 4 **Holograma,** shiriti i argjendtë në të majtë, shfaq me radhë logon e Bankës së Shqipërisë, portretin e Mbretit Gent, vlerën nominale 2000 Lekë dhe lulet Gentiana, të shoqëruar me efekte të ndryshme optike.
- 5 **Figura me ngjyrë të ndryshueshme.** Monedhat e Mbretit Gent në këndin e sipërm djathtas ndryshojnë ngjyrë, nga e artë në të gjelbër, me një efekt dinamik të figurës lart e poshtë.
- 6 **Filli i sigurisë** ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpur.
- 7 Në faqen e pasme të kartëmonedhës, **shiriti i shndritshëm** në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 2000 Lekë.

